



Prishtinë, 12 nëntor 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1304\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15, Nenin 26, Neni 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenin 30, Nenin 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.1, Nenin 34 dhe Nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- Marrëveshjes për Blerje të Energjisë Elektrike (MBA) të lidhur mes ndërmarrjes "Kelkos Energy" SH.P.K. SH.P.K dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A, si dhe
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 24 shkurt 2016 nga ndërmarrja "Kelkos Energy" SH.P.K., adresa: Rr.Sali Çeku, Gogaj Building 14, 51000 Deçan (lokacioni i hidrocentralit: Lumbardhi i Deçanit), Republika e Kosovës.
- Vendimin për Leje Mjedisore, të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), për ndërmarrjen "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan, Hidrocentrali Belaje, me Nr. të Referencës 5837/19/MEA, të datës 06.11.2020

në seancën e mbajtur me datë 12 nëntor 2020, nxori këtë:

## VENDIM

- I. **LËSHOHET** Licencë për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Hidrocentrali "BELAJE" me kapacitet 8.06 MW, ndërmarrjes "Kelkos Energy" SH.P.K., me numër licence ZRRE/LI\_50/20, për periudhën katërdhjetë (40) vjeçare, nga data 12.11.2020 deri me 11.11.2059.
- II. Në periudhën e Licencës të dhënë në pikën I të këtij Vendimi, është llogaritur edhe afati prej dymbëdhjetë (12) muajsh i *licencës së përkohëshme* të lëshuar nga Rregullatori, me vendimin V\_1183\_2019 (i datës 14 tetor 2019) për periudhën nga data 14.10.2019 deri më 13.10.2020.
- III. **Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për "Kelkos Energy" SH.P.K., të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.



## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 24.02.2016 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja "Kelkos Energy" SH.P.K., për hidrocentralin (HC) "BELAJE", me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, me lokacion të këtij Hidrocentrali në Lumbardhin e Deçanit, Komuna Deçan.
- Bordi i Rregullatorit (pas Kërkesës me shkrim nga "Kelkos Energy" SH.P.K) me datë 19 maj 2016 (V\_813\_2016) ka lëshuar vendim për modifikim të autorizimit final për HC Belaje, ku lejon ndryshimin e kapacitetit nga 9.2 MW në 8.06 MW.
- Për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, përveç tjerash kërkohet edhe Leje Mjedisore e Integruar. "Kelkos Energy" SH.P.K., në pamundësi të nxjerrjes së Lejes Mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) (tani Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit- MEA), kishte dorëzuar në Rregullator dëshminë "Forma e Aplikimit për Leje Mjedisore" të datës 27.09.2019 për t'u pajisur me Leje Mjedisore nga kjo Ministri, për HC Belaje.
- Rregullatori, duke u bazuar në Nenin 5 paragrafin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, me vendimin V\_1183\_2019 fillimisht i kishte lëshuar Licencë të përkohshme (me numër licence ZRRE/Li\_50/16) ndërmarrjes në fjalë, për periudhën nga data 14.10.2019 deri më 13.10.2020, me kusht që ndërmarrja të sjell në Rregullator Lejen Mjedisore brenda dymbëdhjetë (12) muajsh.
- Brenda afatit të sipërcekur, aplikuesi nuk ka arritur të pajiset me Leje Mjedisore, kështu që me 13.10.2020 afati i Licencës së përkohshme kishte skaduar, andaj operimi i HC Belaje është ndërprerë.
- Me datë 10 nëntor 2020, përfaqësues të ndërmarrjes "Kelkos Energy" SHPK kanë dërguar në Rregullator "Vendimin për Leje Mjedisore", të lëshuar nga Ministria përkatëse (Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit), me Nr. të Referencës 5837/19/MEA, të datës 06.11.2020, e cila mbulon periudhën pesë (5) vjeçare.
- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe legjislacionit në fuqi, kështu që pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes "Kelkos Energy" SH.P.K, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

**Vendimi i dërgohet:**

- Ndërmarrjes "Kelkos Energy" SH.P.K, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i Rregullatorit:**



---

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar



---

Selman Hoti, anëtar



---

Izet Rushiti, anëtar